



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 266/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Kandidatit për deputet Arsim Bajrami, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Prishtinë, për shkak të mungesës së votave, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Kandidatit për deputet Arsim Bajrami, nga subjekti politik PDK në Prishtinë,

URDHËROHET KQZ-ja që të rinumëroj fletëvotimet në Qendrën e Votimit 2130b VV 01R dhe 02D, Prekaz i Ulët, Komuna e Skenderajt, dhe ky numërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve të parakohshme Parlamentare të 08 qershorit 2014.

Halil Veliqi, në cilësinë e kryesuesit të Vendvotimit (VV) 2130B/02D, nga subjekti politik AAK, me nr të letërnjoftimit 2171138577, i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 5 vite si kandidat i subjektit politik AAK, ose i ndonjë partie tjetër, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor të menaxhuara nën autoritetin e KQZ-së.

Sali Lushtaku në cilësinë e anëtarit të Vendvotimit (VV) 2130B/02D, nga subjekti politik PDK, me nr të letërnjoftimit 1030076601 i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 4 vite si kandidat i PDK-së ose i ndonjë partie tjetër, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor të menaxhuara nën autoritetin e KQZ-së.

Naim Mehaj në cilësinë e anëtarit të Vendvotimit (VV) 2130B/02D, nga subjekti politik LDK, me nr. të letërnjoftimit 1173830013 i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 4 vite si kandidat i LDK-së ose i ndonjë partie tjetër, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor të menaxhuara nën autoritetin e KQZ-së.

Enver Mehmeti në cilësinë e anëtarit të Vendvotimit (VV) 2130B/02D nga subjekti LVV, me nr të letërnjoftimit 2005892557 i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 4 vite si kandidat i LVV-së ose i ndonjë partie tjetër, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor të menaxhuara nën autoritetin e KQZ-së.

Faik Veseli në cilësinë e anëtarit të Vendvotimit (VV) 2130B/02D, nga subjekti politik AKR, me nr të letërnjoftimit 1005314123 i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 4 vite si kandidat i AKR-së ose i ndonjë partie tjetër, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor të menaxhuara nën autoritetin e KQZ-së.

Musa Beqiri në cilësinë e anëtarit të Vendvotimit (VV) 2130B/02D, nga subjekti politik Nisma, me nr të letërnjoftimit 1008623046 i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 4 vite si kandidat i NISMA-së ose i ndonjë partie tjetër, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor të menaxhuara nën autoritetin e KQZ-së.

Liridon Gashi në cilësi të anëtarit të Vendvotimit (VV) 2130B/02D, nga OJQ N. Tereza me nr të letërnjoftimit 1174576200 i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 4 vite si anëtarë i OJQ-së "Nena Terezë", kandidat i një partie, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor të menaxhuara nën autoritetin e KQZ-së.

A R S Y E T I M

Kandidati për deputet në Kuvendin e Kosovës Arsim Bajrami nga subjekti politik PDK, në Prishtinë, ka parashtruar ankesë më datë 09.06.2014, në të cilën pretendon se në VV 2130B/02D në kuadër të QV 2130B në Prekaz të Ulët-Skenderaj, ka mungesë të votave.

Po ashtu, sipas pretendimeve të parashtruesit të ankesës, si përgjegjës për mungesën e gjithsejtë 65 votave është komisionari i këtij VV.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me datë 10.06.2014 e informoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për ankesën që është paraqitur për mungesën e votave dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë, deri më datë 10.06.2014 në ora 13.30, për sigurimin e kopjes së materialit zgjedhor.

Brenda afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga KQZ, me nr. 1359/A 2014, të cilës i kanë bashkangjitur materialin zgjedhor për vendvotimin 2130B/01R dhe 2130B/02D si dhe,

- Listën Përfundimtare të Votuesve
- Formularët e Përputhjes së Rezultateve
- Formulave e Rezultateve të Kandidatëve dhe
- Librin e Votimit

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga materiali zgjedhor i QV 2130B/02D, dhe Formulari i Përputhjes së Rezultateve në rubrikën ku shënohet numri i nënshkrimeve në listën përfundimtare të votuesve dhe rubrika ku shënohet numri i fletëvotimeve në kuti të votimit për këtë QV ka

mospërputhje të rezultati. Numri i nënshkrimeve në rubrikë është 377 ndërsa numri i fletëvotimeve në kuti është 392.

Nga kjo rezulton, se me këtë rast, konstatohet se ka mospërputhje të rezultateve në mes të nënshkrimeve dhe fletëvotimeve në VV e theksuar me lartë. Për këto arsye, PZAP vlerëson se këto veprime në bazë të nenit 119 paragrafi 5 i LZP-së paraqesin padrejtësi serioze.

Me që PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze, në bazë të nenit 115.1 e lidhur më nenin 119.5 të LZP-së, vendosi ne tersi si ne dispozitiv te këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 266/2014 më datën 12.06.2014.

Kryesuesi Panelit
Muhamet Rexha

